



**Informim javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°29/2022

Hagë, 18/08/2022

Përditësim

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve një përditësim mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të drejtuar pyetje.

Informimi javor i sotëm mbulon zhvillimet në proceset që pak para fillimit të periudhës së pushimit të gjykatës në fund të korrikut.

Në çështjen Salih Mustafa, Mbrojtja dhe Prokuroria dorëzuan dosjet gjyqësore përfundimtare të tyre më 21 dhe 22 korrik. Deklaratat përmbyllëse në këtë çështje janë planifikuar për 13-15 shtator.

Në çështjen kundër Hashim Thaçit dhe të bashkakuzuarve, më 22 korrik, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi një vendim me të cilin miratoi, pjesërisht, kërkesën e Thaçit që pretendon mangësi në versionin e fundit të aktakuzës kundër të akuzuarve në këtë çështje.

Në vendim, Gjykatësi urdhëroi Prokurorin e Specializuar të shtojë emrat përkatës të kryesve të drejtpërdrejtë të krimeve dhe viktimave, si dhe vendndodhjet përkatëse që lidhen me disa paragrafë në aktakuzë dhe të dorëzojë aktakuzën e ndryshuar më tej deri më 30 shtator. Vendimi është i disponueshëm në faqen e internetit.

Po në këtë çështje, më 26 korrik, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vazhdoi paraburgimin e Kadri Veselit dhe Gjykata e Apelit hodhi poshtë apelet kundër vendimeve mbi paraburgimin e Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit më 29 korrik dhe 2 gusht.

Më 15 gusht 2022, Paneli i Gjykatës Supreme, i përbërë prej Gjykatësve Ekaterina Trendafilova (kryegjykatëse), Kristinë van den Vajngart dhe Mihael Bolander, hodhën poshtë kërkesën e z. Veseli për mbrojtje të ligjshmërisë në lidhje me vendimin e





**Informim javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°29/2022

Hagë, 18/08/2022

Panelit të Gjykatës së Apelit të datës 31 mars 2022, që konfirmoi vendimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi vazhdimin e paraburgimit të z. Veseli.

Më 11 gusht 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake Giju nxori vendimin e dytë për pjesëmarrjen e viktimave në çështjen kundër Pjetër Shalës, me të cilin pranoi si viktimë pjesëmarrëse në proces një person tjetër që kishte paraqitur kërkesë. Kjo çështje gjyqësore tani ka dy viktima pjesëmarrëse, që përfaqësohen nga e njëjta mbrojtëse e viktimave.

Më 29 korrik, ZPS-ja dorëzoi listën e ndryshuar të dëshmitarëve dhe të provave në çështjen Shala.

Në çështjen e Hysni Gucati dhe Nasim Haradinajt, pas njoftimeve në qershor nga të dy të akuzuarit se do të apelojnë aktgjykimin, afati për parashtrimin e apeleve me shkrim është 19 gushti.

Versioni i redaktuar publik i aktgjykimit në çështjen Gucati dhe Haradinaj tani është i disponueshëm në shqipe. Vendimi së bashku me informacionin e përditësuar për këtë çështje mund ta gjeni në faqen e internetit të DHSK-së të dedikuar për këtë çështje gjyqësore.

**Pyetje nga gazetarët
Nuk pati pyetje.**

